

## Vendim nr. 241 datë 18.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 18.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **KUJTIM EKONOMI**

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 10-2017-1007 (402), datë 27.04.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2022-1347, datë 20.06.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi rezulton se është bashkëpronar në një pasuri të paluajtshme, të ndodhur në qytetin e Durrësit. Për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me këtë pronë, disa prej bashkëpronarëve i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi, me objekt pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme në bashkëpronësi.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 146, datë 07.10.2016, ka vendosur lejimin e pjesëtimit të pasurisë, duke përcaktuar dhe pjesët takuese për secilin bashkëpronar. Mbi ankimin e kërkuesit, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2017-1007 (402), datë 27.04.2017, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1347, datë 20.06.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Në datën 30.07.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 08.08.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

4.1. *E drejta e pronës dhe parimi i sigurisë juridike, e drejta për t'u mbrojtur dhe ajo për t'u dëgjuar*, pasi vendimet e gjykatave janë dhënë në kundërshtim me ligjin dhe vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë. Zhvillimi i gjykimit në gjykatën e apelit është bërë pa praninë e kërkuesit.

4.2. *E drejta e aksesit dhe standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar dhe për me tepër që gjykimi është zhvilluar në dhomën e këshillimit, pa marrë në shqyrtim dhe pa analizuar provat ose shkaqet ligjore të parashtruara në rekurs. Arsytimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe i sforcuar.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuesit*

5. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person

fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

6. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

7. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, vërehet se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

8. Për sa i përket legjitimitit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi ka përfunduar me vendimin nr. 00-2022-1347, datë 20.06.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 30.07.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra pas rreth 2 vjetëve e shtatë muajve. Nga komunikimi elektronik i datës 30.09.2024, Gjykata e Lartë ka konfirmuar se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi është publikuar në faqen e saj zyrtare, duke u bërë i disponueshëm për palët në datën 19.09.2022, datë nga e cila deri në datën e paraqitjes së ankimit kushtetues individual kanë kaluar afërsisht 2 vjet.

10. Në lidhje me këtë fakt, kërkuesi ka argumentuar se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, pasi me vendimin e kundërshtuar të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, është njoftuar në datën 30.04.2024. Për këtë arsye, ai ka paraqitur edhe një shkresë të Gjykatës së Lartë me nr. 1997/1 prot., datë 24.04.2024, ku kjo e fundit, në përgjigje të kërkesës së tij të datës 19.04.2024, e informon se vendimi i asaj gjykate është shpallur në datën 22.06.2022, duke i vënë në dispozicion edhe një kopje të vendimit.

11. Gjithashtu, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim në ankimin kushtetues individual lidhur me mungesën e njoftimit të vendimit të Gjykatës së Lartë në adresën elektronike të tij ose të mbrojtësit të zgjedhur, ndërkohë që nga aktet që shoqërojnë kërkesën nuk rezulton se ata (kërkuesi dhe mbrojtësi i zgjedhur) të kenë lënë të dhënat e adresës elektronike. Referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se për shqyrtimin e çështjes civile të kërkuesit në dhomën e këshillimit të datës 20.06.2022 është bërë njoftim në datën 01.06.2022.

12. Ndërkohë, në ankimin kushtetues individual kërkuesi nuk ngre pretendime për pamundësinë e tij për t'u informuar për gjendjen në të cilën ndodhej shqyrtimi i çështjes së tij në Gjykatën e Lartë. Për sa kohë ai ka qenë në dijeni të faktit se çështja, për rekursin e tij, ndodhej për gjykim në Gjykatën e Lartë, kërkuesi ka pasur mundësi, por edhe detyrimin për t'u kujdesur për ndjekjen e fatit të çështjes. Pretendimi i kërkuesit në lidhje me momentin e marrjes dijeni për vendimin e kundërshtuar, në mungesë të argumenteve dhe provave lidhur me pamundësinë e marrjes dijeni për vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë, nga momenti kur ai ka qenë i disponueshëm për palët, nuk është i mjaftueshëm për të provuar në nivel kushtetues se data e pretenduar prej tij duhet të konsiderohet si data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e kundërshtuar.

13. Për sa më lart, duke analizuar argumentet e paraqitura nga kërkuesi në raport me standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, Kolegji evidenton se ai nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme nga data në të cilën vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, moment nga i cili fillon të ecë afati ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, ai nuk legjitimohet *ratione temporis* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues dhe, për këtë arsye, nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësimit të kritereve të tjera të pranueshmërisë së kërkesës.

14. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.